

MSA-ja për të gjithë



Çfarë duhet të dini për marrëveshjen për stabilizim dhe asociim ndërmjet BE-së dhe Kosovës

MSA-ja për të gjithë

Çfarë duhet të dini për marrëveshjen për stabilizim dhe asociim ndërmjet BE-së dhe Kosovës

Autor: Krenar Gashi

Redaktorë: Joanna Hanson, Micaela Thurman, Dardan Velija,
Dinka Živalj, Naim Huruglica

Dizajn dhe radhitje: Nol Markaj, PR Solutions

Ilustrimet: Nerila Lila, Emeron

Përmbajtja

I.	Hyrje	4
II.	Bashkimi Evropian: një histori e integrit	5
III.	Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit dhe ndikimi i tij në BE dhe Kosovë	8
IV.	MSA-ja dhe demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut	12
V.	MSA-ja dhe ekonomia	15
VI.	MSA-ja dhe bashkëpunimi rajonal	19
VII.	MSA-ja dhe ju	20

I. Hyrje

Në prill të vitit 2016 hyri në fuqi Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim (MSA) ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Kosovës. Kjo është marrëdhënia jonë e parë kontraktuale dhe një hap i rëndësishëm për Kosovën në rrugën e saj për në BE. Kjo është e arritur e madhe për Kosovën.

Marrëveshja nuk është vetëm një dokument i nivelit të lartë politik nga dhe për institucionet dhe politikanët. Përmes kësaj marrëveshjeje është dakorduar një proces për mbështetje reale të reformave, i cili do të ndikojë në mundësitë dhe jetën e qytetarëve. Krahas me zbatimin gradual të MSA-së, gjë e cila do të kërkojë angazhim dhe përpjekje të qëndrueshme të politikanëve dhe institucioneve publike të Kosovës, duhet të ndodhin edhe ndryshime në cilësinë e jetesës. Për shembull, forcimi i sistemit gjyqësor, përmirësimi i kushteve të të drejtave të njeriut, forcimi i institucioneve demokratike, qasja më e madhe dhe e garantuar në tregjet evropiane, përmirësimi i cilësisë dhe standardit të prodhimeve nga Kosova, në mënyrë që ato të jenë më tërheqëse për konsumatorët gjithandej tregut të gjerë të BE-së, si dhe mbështetja për progres drejt një ekonomie të orientuar në treg.

Me qëllimin që marrëdhënia të japë rezultat të plotë, çdo qytetar në Kosovë mund të luajë një rol në mënyrën e vet - si qytetarë që i mbajnë politikanët përgjegjës për dakordimin me MSA-në, si persona afarist që përfitojnë nga mundësitë e ofruara nga MSA-ja.

Shpresojmë që ky publikim do ta shpjegojë më së miri se si marrëdhënia e Kosovës me BE-në do të thellohet për shkak të MSA-së, kështu që në mënyrë aktive mund ta ndiqni, apo edhe vetëm të kuptoni më mirë, procesin përmes të cilit Kosova përafrohet me BE-në.



II. Bashkimi Evropian: Një histori e integritimit

Me 28 shtetet e saj anëtare, BE-ja është një forcë e fuqishme [për të mirë] në botë. BE-ja është tregu më i madh i përbashkët në botë, që përbën gati një të katërtën e prodhimit ekonomik global dhe një të pestën e tregtisë globale. Me mbi 508 milionë banorë, është tregu i tretë më i madh në botë për nga popullsia, pas Kinës dhe Indisë. Njëzet e katër gjuhë zyrtare dhe mbi 60 gjuhë indigjene, rajonale dhe minoritare fliten nga qytetarët në të gjithë BE-në. Bashkimi bën bashkë shtetet kombëtare në të gjithë kontinentin në një mënyrë historikisht të paparë për të ndarë vlerat e përbashkëta dhe përfitimet e punës së përbashkët, qoftë në çështjet politike apo ekonomike.

BE-ja funksionon mbi parimin e integritimit, si vertikal ashtu edhe horizontal. Integrimi vertikal, apo thellimi i Bashkimit, ndodh kur shtetet anëtare bien dakord për të ndarë ose bartur kompetencat e tyre kombëtare në nivelin e BE-së, duke rënë dakord se politikat mund të zbatohen më mirë në atë nivel. Për shembull, 19 nga 28 shtetet anëtare janë tashmë duke përdorur monedhën evropiane - euron, ndërsa 25 vende (përfshirë edhe tri që nuk janë në BE), kanë hequr kufijtë midis tyre përmes Marrëveshjes së Shengenit. Integrimi horizontal, ose zgjerimi i Unionit, ka të bëjë me zgjerimin e Bashkimit për të përfshirë vende të tjera evropiane si shtete anëtare të BE-së. Kjo ofertë është e hapur, për shembull, për vendet e Ballkanit Perëndimor. Derisa BE-ja thellohet e zgjerohet, vazhdon të ndryshojë dhe të zhvillohet, duke u përshtatur ndaj nevojave të shteteve anëtare të saj.


Integrimi evropian, megjithatë, është një proces i gjatë. Ata të cilët dëshirojnë të bashkohen me BE-në, duhet t'i përmbushin standardet e caktuara, duke ndarë vlera të njëjta demokratike


dhe parimet ekonomike të bazuara në treg si shtetet anëtare ekzistuese, për shembull, vendet duhet ta kenë një ekonomi tregu funksionale me kapacitet






për t'u përballuar me konkurrencën në nivel të BE-së dhe aftësinë për të zbatuar detyrimet (jo vetëm përfitimet) e anëtarësimit në BE. Miratimi dhe përafrimi i legjislacionit kombëtar dhe proceseve me nivelet dhe standardet e BE-së nuk ka të bëjë vetëm me përkthimin dhe miratimin e një ligji, por më tepër me një proces të gjatë transformues, gjatë të cilit vendet mësojnë se si shtetet anëtare ekzistuese kanë vepruar, pasi që ata vetë zbatojnë reformat e nevojshme për ta bërë të mundur bashkimin me BE-në.

Siç e kemi parë nga zgjerimet e fundit të BE-së, shumë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore, si Malta, Qiproja e më vonë Bullgaria, Rumania dhe së fundi Kroacia u bashkuan me BE-në. Procesi i integritit është progresiv dhe transformues. 66 vjet pas themelimit të Bashkimit Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor, bashkimin me BE-në, e kanë bërë objektivin e tyre kryesor të politikave. BE-ja është partner natyror i Kosovës. Sot BE-ja është investitori më i madh i huaj në Kosovë, dhe partneri i saj tregtar numër një, përveç ofrimit të gjysmës së ndihmës së përgjithshme ndërkombëtare në Kosovë. Si demokracia më e re në Evropë, Kosova tani është duke përparuar në rrugën e saj evropiane të integritit dhe vazhdon të luajë një rol kyç në zhvillimin institucional dhe ligjor.





BE-ja, sikurse shtetet, ka institucione-legjislativë të zgjedhur drejtpërdrejt (Parlamenti Evropian) dhe Këshillin që mbledh ministrat nga shtetet anëtare të BE-së, që vendosin bashkë mbi një spektër të gjerë të çështjeve politike. Gjithashtu, ka një shërbim ekzekutiv/civil (Komisioni Evropian), që përgatitë, zbaton propozimet dhe siguron, bashkë me Gjykatën e Drejtësisë, që shtetet anëtare t'i respektojnë ligjet dhe Traktatet për të cilat janë dakorduar. Mbi këto, duke siguruar udhëheqje politike, është Këshilli Evropian, i përbërë nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të ahteteve anëtare. BE-ja punon me anë të një sërë zotimesh në mes të anëtarëve të saj, me Traktatet e detyrueshme, legjislacionet e dakorduara, vendimet e detyrueshme të gjykatave dhe parimet e tjera të përbashkëta, të cilave bashkërisht u referohemi si 'acquis' (frëngjisht për 'ajo që është arritur/fitur', në këtë rast legjislacioni i akumuluar, aktet ligjore dhe vendimet e gjykatës që përbëjnë trupin e ligjit të Bashkimit Evropian).



III. Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit- ndikimi i tij në BE dhe në Kosovë

Korniza e politikave

Korniza kryesore e politikave të BE-së për Ballkanin Perëndimor është Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit (PSA). Në thelb të këtij procesi janë Marrëveshjet për Stabilizim dhe Asociim (MSA), të nënshkruara ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor. Këto janë mjetet që transformojnë procesin e integritimit nga teoria në një realitet kontraktual. Siç e shpjegon kjo broshurë, Marrëveshjet i përcaktojnë rregullat, por procesi i integritimit, ndikimi i tij dhe rezultatet në jetën e përditshme të njerëzve, në radhë të parë varen nga shkalla në të cilën Kosova i zbaton dispozitat e saj, me ndihmën praktike dhe inkurajimin e BE-së.



Bazat e MSA-së:

Kosova tani ka **marrëdhënie kontraktuale zyrtare** me BE-në, e cila marrëdhënie e ndërsjella i bazon në parimet kryesore të dakorduara.

MSA-ja ndërmjet Kosovës dhe BE-së u ratifikua nga Kuvendi i Kosovës dhe Parlamenti Evropian.

Kush e nënshkroi? Kosova dhe BE.

Ku? Parlamenti Evropian në Strasburg, Francë, dhe Kuvendi në Prishtinë,

Kur hyri në fuqi? 1 prill 2016.

Shpjegimi i MSA-së

MSA-ja nuk është vetëm një marrëveshje e tregtisë, por shkon përtej saj për nga natyra dhe përmbajtja. Marrëveshja është një dokument voluminoz, i ndarë në dhjetë kapituj që mbulojnë çështjet që shtrihen nga ajo se si do të ndërveprojmë politikisht (dialogu politik); bashkëpunimi rajonal, lëvizja e lirë e mallrave, furnizimi i shërbimeve dhe kapitalit, përafrimi i ligjeve të Kosovës me ato të BE-së, bashkëpunimi për lirinë, sigurinë dhe drejtësinë, si dhe në sektorët e tjerë, ndihma financiare e BE-së për reformat në Kosovë, dhe në cilat organe do të punojmë bashkërisht. Disa nga dispozitat e Marrëveshjes janë të përbashkëta me vendet e tjera, teksa dispozitat e tjera janë unike për Kosovën. Në përgjithësi, Marrëveshja përcakton objektiva të qarta politike dhe ekonomike në arritjen e të cilave Kosova është zotuar të punohet gjatë viteve të ardhshme.

Me pak fjalë, MSA-ja dhe organet e saj janë një mjet për Kosovën dhe BE-në, që së bashku ta drejtojnë procesin e integritimit. MSA-ja, mbulon të gjitha fushat, të cilat BE-ja dhe Kosova i konsiderojnë thelbësore: demokracinë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit, ekonominë e tregut dhe tregtinë, si dhe bashkëpunimin rajonal e marrëdhëniet e mira fqinjësore. Sikurse edhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare, MSA-ja përmban detyrime për të dy palët. Për të përcjellë dhe inkurajuar zbatimin e këtyre detyrimeve dhe reformave në përgjithësi, ajo gjithashtu krijon disa organe mbikëqyrëse për zbatimin e saj.




Organet e MSA-së

Ekziston Këshilli i Stabilizimit dhe Asociimit (SA), me përfaqësues të nivelit të lartë si të BE- së ashtu dhe të Kosovës (për shembull BE-ja përfaqësohet nga Përfaqësuesi i Lartë/Zëvendës Presidenti dhe Komisioneri për Zgjerim dhe një ministër e përfaqëson Kosovën), duke kryesuar me radhë. Ky Këshill mbikëqyr dhe vlerëson procesin përmes një takimi vjetor. Këshilli ndihmohet nga Komiteti i Stabilizim-Asociimit, i cili gjithashtu mbledhet çdo vit, në nivel të nëpunësve civil të lartë në mes të Komisionit Evropian dhe institucioneve të Kosovës. Këto dy organe të nivelit të lartë mbështeten nga nën-komitetet, duke përfshirë nëpunësit civilë të Kosovës dhe të Komisionit Evropian, të cilët takohen gjatë vitit për të diskutuar dhe për të monitoruar progresin në fushat specifike të MSA-së.

Ekziston edhe Komisioni i Përbashkët Parlamentar i SA-së, që përfshinë anëtarët e Kuvendit të Kosovës, që përfaqësojnë të gjitha partitë politike përfshirë edhe ata nga opozita, si dhe anëtarë të Parlamentit Evropian, nga i gjithë spektri politik. Ky Komision Parlamentar është i rëndësishëm pasi që u ofron qytetarëve mundësi për të mbajtur përfaqësuesit e zgjedhur të përgjegjshëm për zbatimin e MSA-së.

Këto struktura të përbashkëta institucionale menaxhojnë procesin duke mbikëqyrur së bashku zbatimin e MSA-së. Përderisa BE-ja i ofron këshilla teknike dhe mbështetje financiare Kosovës për reformat e saj, institucionet e Kosovës janë ekskluzivisht përgjegjëse për zbatimin e Marrëveshjes.

Kosova dhe BE-ja kanë bashkëpunuar në të kaluarën në shumë aspekte të mbuluara nga MSA-ja. Ky bashkëpunim ishte i bazuar në vullnetin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë. MSA-ja e ngre këtë bashkëpunim të ndërsjellë në nivel kontraktual, institucional, me theks të shtuar në sigurimin që manovrimi politik, i projektuar për të shmangur obligimet, nuk do t'i lejohet asnjërës palë nënshkruese.



MSA-ja dhe integrimi evropian

Prezenca e institucioneve të reja të përbashkëta për shkak të MSA-së është gjithashtu ndryshim i madh për procesin e integritit evropian ekzistues të Kosovës. Korniza institucionale e dedikuar, me përfaqësuesit e Kosovës dhe të BE-së që punojnë së bashku, do të rrisë efektivitetin e përgjithshëm të procesit të integritit. Këto organe do të ndihmojnë për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë më efektive sfidat në zbatimin e reformave, dhe duhet të përmirësojnë koordinimin brenda dhe ndërmjet institucioneve të Kosovës, kur është fjala për procesin e integritit. Për qytetarët e thjeshtë, kjo do të thotë më shumë transparencë në lidhje me procesin e përafrimit me BE-në.

Kosova tashmë ka një Program Kombëtar për Adoptimin e Acquis-së (PKMA), me të cilin planifikon dhe zbaton procesin e përafrimit të legjislacionit të Kosovës me atë të BE-së. MSA-ja ndihmon këtë duke mbështetur miratimin e kornizave të rëndësishme ligjore me ndikim si p.sh. në mbrojtjen e konsumatorit, konkurrencën dhe sigurinë e produkteve. Tani, Programi i ri Kombëtar i Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit do të ndihmojë për të siguruar koherencë të përpjekjeve të Qeverisë për tu përputhur me rregullat e BE-së. MSA-ja dhe organet e saj do të ndihmojnë, në veçanti, për të përcjellë dhe identifikuar/adresuar problemet eventuale me zbatimin, në hapin që është gjithmonë më i vështiri i përkthimit të qëllimeve dhe zotimeve në strategji dhe ligje dhe, eventualisht në përfitimet reale për qytetarët.



IV. MSA dhe demokracia, sundimi i ligjit dhe të drejtat e njeriut

Qëllim madhor i asociimit të Kosovës me BE-në është forcimi i demokracisë dhe sundimit të ligjit, duke përfshirë edhe luftimin e korrupsionit. Kjo nënkupton të ndihmohen institucionet për të funksionuar më shumë si institucionet e tjera demokratike evropiane, duke punuar drejt një sistemi të fuqishëm demokratik, me kontrole dhe balanca të vendosura, ku përfaqësuesit janë të zgjedhur lirisht e në mënyrë të drejtë për të qeverisur, ndërsa qytetarët që i kanë zgjedhur ata, i mbajnë përgjegjës për qeverisjen. MSA-ja është një mjet i rëndësishëm për të mbështetur reformat për të arritur këtë qëllim të përbashkët.



Elementet kryesore të MSA-së:

- Respektimi i ligjit dhe instrumenteve ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut;



- Fuqizimi i kapacitetit administrativ i të gjitha niveleve të administratës;



- Përforcimi i pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit;

- Fuqizimi i sundimit të ligjit në sferën e afarizmit me anë të një kornize ligjore të qëndrueshme dhe jo diskriminuese;



- Zhvillimi i strukturave adekuate për policë, prokurorë dhe gjyqtarë që ta bëjnë punën e tyre;

- Zhvillimi i një administrate publike profesionale, efikase dhe të përgjegjshme në Kosovë;




- Zotimi për ta luftuar korrupsionin në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Sundimi i ligjit është i një rëndësie të veçantë për Kosovën.

Efektiviteti dhe efikasiteti i gjyqësorit nuk është thjesht një tregues abstrakt që tregon se a është Kosova në rrugën e saj evropiane apo jo, por është i rëndësishëm në jetën e përditshme të qytetarëve të zakonshëm. Problemet aktuale me sistemin gjyqësor, si dhe akuzat për korrupsion dhe keqmenaxhim, mund të minojnë besimin e qytetarëve të Kosovës në këto institucione.

Pse është e rëndësishme?

Mungesa e besim të plotë në sistemin gjyqësor nuk ndikon vetëm në jetën e qytetarëve, por edhe largon investorët e huaj nga investimi në Kosovë dhe në fund ulë zhvillimin dhe mundësitë e punësimit. Gjithashtu, ndikon në reputacionin e Kosovës jashtë vendit. Zhvillimi ekonomik dhe zhvillimi i institucioneve të sundimit të ligjit shkojnë krahas, sikurse edhe zhvillimi i sektorit privat.





Respektimi i të drejtave të njeriut është një parim themelor dhe i padiskutueshëm evropian. MSA-ja gjithashtu thekson këto parime të rëndësishme. Nën MSA do të jetë një forum për një dialog në rritje rreth politikave për të drejtat e personave që u përkasin komuniteteve, pakicave dhe grupeve në nevojë, siç janë gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, dhe komuniteti LGBT. Në bazë të konsultimeve me shoqërinë civile dhe atyre që përfaqësojnë këto komunitete, këto çështje do të ngrihen dhe diskutohen në takimet e Nënkomitetit, Komitetit dhe Këshillit të MSA-së.

Raporti i fundit (2015), i Komisionit për Kosovën vë në dukje se zbatimi i të drejtave të njeriut është ndikuar negativisht nga mungesa e burimeve dhe angazhimit politik, madje edhe në nivelin lokal. Pasi që këto çështje tani do të diskutohen në organet e përbashkëta të themeluara nga Marrëveshja, Kosova duhet të angazhohet në reformën sistematike në këto fusha, duke u fokusuar në zbatimin apo rishikimin e legjislacionit relevant, të mbështetur nga burimet e nevojshme dhe angazhimi politik.


Marrëveshja në këtë mënyrë ofron një kontekst të përmirësuar për të monitoruar dhe për të inkurajuar respektin për të drejtat e njeriut. Qytetarët, në mënyrë të barabartë, mund të angazhohen në një diskurs më të madh qytetar dhe të mbajnë zyrtarët më të përgjegjshëm për të mbështetur parimet për të cilat kanë rënë dakord në MSA.

V. MSA-ja dhe ekonomia

MSA-ja si mjet për të sjellë prosperitet dhe mundësi më të mëdha ekonomike

Me shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë dhe zhvillimin ekonomik që po lëvizë shumë ngadalë, është e nevojshme përpjekje e madhe, duke përfshirë edhe reformat dhe investimet, për të përmirësuar kushtet ekonomike. Përderisa nënshkrimi i MSA-së me BE-në është një hap pozitiv në vetvete, zbatimi i saj do të hapë rrugën për qasje në tregje të reja, përmirësime në standardet e prodhimit dhe standardizim, gjë që nga ana tjetër do ta rrisë eksportin potencial dhe do të ndihmojë zhvillimin e biznesit vendor, rritjen e sigurisë si dhe besimit për investitorët e huaj. Të gjitha këto duhet të kontribuojnë në prosperitet më të madh dhe mundësi punësimi në tërë Kosovën.

MSA-ja do të vë në dispozicion për qytetarët produkte më të shumta e më të mira. Gjatë zbatimit të MSA-së, Kosova pritet që gradualisht të përqafojë dhe zbatojë standardet evropiane për produktet, sidomos për sa i përket mbrojtjes së konsumatorëve dhe cilësisë së produkteve. Përvoja në lidhje me këtë nga Shteti Anëtar i fundit që ka hyrë në Bashkim, Kroacia, tregon se këto reforma të favorshme për konsumatorin gjithashtu mbështesin zhvillimin e sektorit privat dhe tregjet lokale.



Avancimi i pozitës së Kosovës në tregtinë ndërkombëtare është një tjetër objektivi i MSA-së, duke ndihmuar rregullimin e mosbalancimit tregtar aktual, nëpërmjet ofrimit të mundësive të reja për eksportet nga Kosova. Në vitin 2014, Kosova ka importuar më shumë se një miliard euro në mallra nga BE, por ka eksportuar më pak se 100 milionë euro në këmbim. MSA-ja ka për qëllim të vendosë produktet e BE-së dhe Kosovës (të cilat përmbushin standardet e cilësisë të BE-së) në një fushë loje të niveluar, duke i dhënë shumicës së produkteve të Kosovës qasje të pakufizuar në tregun e BE-së. Për shembull, një prodhues i verës në Rahovec nuk e ka të garantuar vetëm tregun në Kosovë, por tani mund të përfitojë nga kuota e Kosovës për eksport të verës, që është rritur dhe tanimë është e garantuar nga MSA-ja, duke i dhënë qasje në mbi 500 milionë konsumatorë potencial.

Shumica e produkteve industriale dhe bujqësore të Kosovës tani do të kenë qasje të garantuar në tregun e BE-së. Në disa raste, Kosova do të jetë në gjendje të mbrojë tregun e saj për produkte të caktuara (p.sh. produktet e qumështit, mollët dhe patatet), ashtu që produktet e BE-së, vetëm gradualisht të arrijnë trajtim të barabartë, duke u dhënë kohë prodhuesve të Kosovës për të përmirësuar cilësinë dhe standardet e tyre për të qenë konkurrues në këta sektorë.



MSA-ja, megjithatë, nuk është preventivë ekonomike për të gjitha. Kosova do të vazhdojë të përballet me sfida serioze ekonomike. Qasja e garantuar në tregjet e BE-së, do të sjellë përfitime të plota vetëm nëse gama dhe cilësia e produkteve të Kosovës përmirësohet për të qenë sa më konkurruese që është e mundur. MSA-ja do ta japë potencialin e saj të plotë nëse Kosova fokusohet në forcimin e sektorëve të orientuar në tregjet e eksportit, zhvillon infrastrukturën e cilësisë për ti sjellë produktet në ato tregje, siguron se produktet dhe eksportet përmbushin standardin shëndetësor, sigurinë dhe cilësinë e BE-së. Gjithashtu vazhdon të forcojë dhe të mbështesë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, në mënyrë që ato të mund të veprojnë në tregun e përbashkët konkurrues të BE-së. Pasi që asgjë nuk ndodhë në izolim/çdo gjë është e lidhur, këto reforma thelbësore ekonomike shkojnë krahas me përmirësimin e nivelit të demokracisë, sundimit të ligjit e të drejtave të njeriut, për të përfutur plotësisht nga MSA-ja.

BE-ja do të sigurojë mbështetje teknike dhe këshilla, nga përvoja e vet, nëpërmjet strukturave të përcaktuara sipas Marrëveshjes. Do të vazhdojë të ofrojë mbështetje financiare për përpjekjet e Kosovës për të arritur prioritetet dhe synimet e ndërsjella të reformave. Por vullneti politik është kyç - **implementimi i reformave dhe zotimeve të parapara në MSA është çelësi në përdorimin e potencialeve të saj për të sjellë prosperitet më të madh në Kosovë.**





Çfarë bën MSA-ja për mua si qytetar apo si person afarist?

- Kornizën ligjore, e cila lejon ta regjistroni dhe të operoni me një biznes në BE, njësoj sikurse bizneset e BE-së, që mund të operojnë në Kosovë.
- Nëse jeni prodhues, prodhimet tuaja do të kenë qasje më të mirë në tregun e përbashkët të BE-së. Derisa disa produkte janë të kufizuara me kuota, këto kuota janë shumë më të mëdha se sa që ishin në të kaluarën (shih Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për detaje specifike të produkteve).
- Detyrimi për tu harmonizuar me standardet dhe normat e BE-së do të sjellë siguri të shtuar të produkteve dhe mbrojtje të konsumatorëve për të gjithë qytetarët e Kosovës.
- Nëse dëshironi të investoni në BE, apo keni investues të BE-së të interesuar të investojnë në Kosovë, MSA-ja siguron një kornizë të përmirësuar që mbështetë investimet e tilla të jashtme.
- Tarifat doganore janë eliminuar tashmë për shumicën e importeve dhe eksporteve dhe eventualisht do të eliminohen për të gjitha produktet pas 10 vitesh.
- Kompanitë e Kosovës tani kanë të drejtë për kontratat e prokurimit publik të BE-së dhe anasjelltas.



Çfarë nuk bën ajo?

- MSA-ja nuk i lejon fuqisë punëtore të Kosovës qasje të plotë në tregun e vet. Kjo qasje është e kufizuar për kompanitë.
- MSA-ja nuk ka ndikim në liberalizimin e vizave.
- MSA-ja nuk është e lidhur me anëtarësimin e Kosovës në BE. Ajo është një mjet, i cili nëse përdoret siç duhet dhe zbatohet plotësisht, do ta përgatisë Kosovën për t'i përmbushur standardet e BE-së në një gamë të gjerë fushash. Kjo do të varet nga progresi i bërë në drejtim të zbatimit dhe nga faktorë të tjerë.

VI. MSA-ja dhe bashkëpunimi rajonal

BE-ja është shembulli më i madh i bashkëpunimit rajonal. Prandaj, natyrshëm nxitë bashkëpunimin rajonal, jo vetëm ndërmjet vendeve, por edhe me institucionet rajonale, për të mirën më të madhe të Evropës në tërësi.

Për arsye historike, bashkëpunimi rajonal në Ballkanin Perëndimor është pjesë e kushteve që vendet duhet të përmbushin, në mënyrë që të bëhen anëtare të plota të Bashkimit. Bashkëpunimi rajonal, gjithashtu paraqitet në MSA, si një vlerë thelbësore evropiane, si ndërmjet vendeve të rajonit, ashtu dhe ndërmjet shteteve anëtare aktuale të BE-së, e sidomos rajonet e tyre kufitare, për të adresuar bashkërisht sfidat e përbashkëta, duke bashkuar burimet.

Marrëdhëniet e mira fqinjësore kanë qenë parim kryesor i politikës së jashtme të Kosovës. Dialogu Kosovë-Serbi është lehtësuar nga BE-ja, dhe prek shumë fusha të përfshira në MSA.

Kjo është natyrisht edhe një angazhim në kuadër të MSA-së dhe do të mbështetet gjatë zbatimit të saj. Sikurse që Kosova është zotuar me anë të MSA-së për të vazhduar dialogun me Serbinë në mirëbesim dhe për të zbatuar të gjitha marrëveshjet dypalëshe, në të njëjtën mënyrë edhe Serbia ka bërë zotime të ngjashme, si pjesë e bisedimeve të saj të vazhdueshme për anëtarësim në BE.





• Çfarë tjetër do të thotë bashkëpunimi rajonal?


- Duke kërkuar që Kosova të zhvillojë zonën e lirë të tregtisë me vendet e tjera që e kanë nënshkruar MSA-në, MSA-ja plotëson zbatimin e Marrëveshjes së Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) nga Kosova, pjesë e të cilës tashmë është.
- Të pasurit e një MSA-je, promovon bashkëpunimin e rritur me fqinjët dhe me BE-në ,në fushat e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë, posaçërisht nën Politikën e Përbashkëta të BE-së për Siguri dhe Mbrojtje dhe në mbështetje të luftimit të krimit të organizuar dhe terrorizmit.
- Bashkëpunimi rajonal në hulumtim dhe zhvillim, posaçërisht lidhur me mbështetjen e zhvillimit të industrive kryesore, gjithashtu është mbështetur. Për shembull, për të siguruar certifikatat e produkteve, kompanitë e Kosovës inkurajohen të punojnë me laboratorë në BE, si dhe vendet tjera të PSA-së.

VII. MSA dhe ju

Siç është shpjeguar tashmë, rruga drejt BE-së, sikurse për vendet e tjera të rajonit, do të jetë një proces i gjatë dhe transformues. Ky proces nuk do të arrihet nga cilido individ apo institucion që vepron i vetëm. Përkundrazi, ajo përfshin të gjitha institucionet, partitë dhe të gjitha pjesët e shoqërisë.

Reformat që do ti sjellë zbatimin e MSA-së, janë ato që të gjithë i dëshirojnë, pavarësisht se cilës pjesë të spektrit politik apo social i përkisni. Gjithkush mund të luajë një rol në arritjen e tyre: politikanët, qofshin aktualisht në qeveri apo në opozitë, duke treguar vullnetin politik për të ndjekur reformat; nëpunësit civilë në zhvillimin dhe zbatimin e reformave; institucionet tjera në monitorimin dhe ndjekjen e këtyre reformave dhe, pjesa jetike e çdo sistemi demokratik, roli i qytetarëve dhe shoqërisë civile në mbajtjen e qeverisë si përgjegjëse për premtimet e saj dhe reformat e premtuara, afaristët dhe sektori privat duke përfituar nga mundësitë e ofruara nga





marrëveshja dhe në mbajtjen e qeverisë llogaridhënëse për reformat ekonomike. Logjika e MSA-së, bazohet në të gjithë aktorët që luajnë këto role - për të arritur qëllimet e dakorduara të MSA-së, p.sh. një shoqëri plotësisht funksionale, me institucione të zgjedhura në mënyrë demokratike, me një sistem të qartë të kontrolleve dhe balancave të vendosur për të siguruar të drejtat themelore, me një gjyqësor efikas dhe të pavarur, si dhe me një treg të lirë e konkurrues.

Në organet e SA-së, qeveria ka punë me qeverinë, teksa të gjitha partitë politike mund t'i shprehin pikëpamjet e tyre mbi reformat dhe ti mbështesin ato, kur diskutohen në parlament dhe të mbajnë përgjegjëse cilëndo qeveri që është në pushtet për zotimet që vendi ka bërë me nënshkrimin e MSA-së. Përderisa shoqëria civile nuk është e përfshirë drejtpërdrejt në takimet e SA-së, konsultimi paraprak nënkupton se qëndrimet dhe kërkesat e tyre mund të përfshihen në proces, në mënyrë indirekte. Përveç kësaj, si një lidhje e mëtejshme me qytetarët dhe interesat e tyre, që lidhin integrimet në BE dhe jetën e përditshme, janë themeluar departamentet që merren me integrimin evropian në kuadër të secilës ministri, si dhe është caktuar nga një "Zyrtar Komunal i Integritimit Evropian", në secilën nga 28 komunat e Kosovës, të cilët mund tu ofrojnë qytetarëve informacion mbi progresin e vërtetë dhe në çështjet me interes për ta. Sa më proaktiv që janë qytetarët brenda këtij procesit të integritimit, aq më transparent dhe i suksesshëm do të jetë ky proces.

Si mund të përfshiheni në MSA?

- Informohuni. A keni ndonjë interes të veçantë? Qëndroni në rrjedha me zyrtarët tuaj lokal ose kombëtar për të parë se çfarë MSA-ja mund të sjellë për ju si individ, përfamiljen ose biznesin tuaj.
- Qëndroni në kontakt me zyrtarin lokal komunal për Integritet Evropian. Pyetni përpërpërimin në fusha të caktuara dhe çfarë roli ju mund të luani në komunitetin tuaj.
- Qëndroni në kontakt me përfaqësuesit tuaj të zgjedhur parlamentar. Kërkojuni atyre të ngrisin çështjet me interes në mbledhjen e ardhshme të Komisionit Parlamentar për SA-në dhe sigurohuni se ata janë transparentë dhe të përkushtuar për zbatimin e MSA- së.
- Pyetni zyrtarët përkatës të Ministrisë dhe të Agjencisë nëse ekziston mbështetja e BE-së në sektorin tuaj të ekspertizës. Për të mbështetur zbatimin, janë duke u zhvilluar projekte dhe skema të reja nga institucionet qeveritare për të mbështetur Kosovën në zbatimin e MSA-së.
- Përfshihuni në konsultimet për ligjet e reja që rrjedhin nga zotimet nën MSA dhe mbikëqyrni zbatimin e tyre.



Për më shumë informata rreth Bashkimit Evropian në Kosovë



Qendra Informative dhe Kulturore e BE-së

Rruga "Nëna Terezë" nr. 16, Prishtinë 10000, Kosovë

T: +381 (0) 38 25 99 99

F: +381 (0) 38 25 99 25

M: +377 (0) 44 50 95 10

E: pr@euicc-ks.com

Rruga "Čika Jovina" p/n, Mitrovicë Veriore

T: +377 (0) 45 599 592

M: +381 (0) 64 90 97 882

E: mi@euicc-ks.com

www.euicc-ks.com



BASHKIMI EVROPIAN NË KOSOVË

Rruga e Kosovës 1, kutia postare 331,10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 (0) 38 51 31 200; Fax: +381 (0) 38 51 31 305

E-mail: delegation-kosovo@eeas.europa.eu

Web: <http://eeas.europa.eu/delegations/kosovo>

